REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/KOSOVA CUMHURIYETI
KOMUNA E GJILANIT - OŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDYIE
02 Nr/Br/Sig. 536
Data/Datum/Tarih 04.05.2023
GJILAN - GNJILANE - GILAN

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**
**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI**

**ZYRA E KRYETARIT**
**KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI**

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL) nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. nr. 016-126211 të dt. 06.11.2014 me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të dt. 22.03.2018, Kryetari i Komunës së Gjilanit merr këtë:

# VENDIM

1. Lejohet pagesa e mjeteve financiare në shumën prej 400 (katërqind euro) për Alisa Halimin nga Gjilani për pjesëmarrje në festivalin e Gjirokastrës "Gjiro Classica".
2. Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga Kodi Buxhetor-subvencione - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
3. Mjetet derdhen në xhirollogarinë [redacted].
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Marrëveshja për Subvencionim e përfitueses.
5. Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të tij.

**Vendimi i dorëzohet:**

- Palës,
- DKRS,DBF dhe
- Arkivit.

**Kryetari i Komunës**

**Alban Hyseni**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/KOSOVA CUMHURIYETI
KOMUNA E GJILANIT - OŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYE
02 Nr/Br/No 535
Data/Datum/Tarih 04.05.2023
GJILAN - GNJILANE - GILAN

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE**
**MUNICIPALITY OF GJILAN**
**GILAN BELEDIYESI**

---

# MARRËVESHJE PËR SUBVENCIONIM

**ndërmjet**

**Komunës së Gjilanit si autoritet publik**

**dhe**

**Alisa Halimi nga Gjilani, përfituese**

**Gjilan, 2023**

**Neni 1**
**Qëllimi i marrëveshjes**

1. Qëllimi i kësaj marrëveshje është subvencionimi i Alisa Halimit nga Gjilanit, për pjesëmarrje në festivalin në Gjirokastër "Gjiro Classica".
2. Marrëveshja është lidhur sipas procedurës së përcaktuar me Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 2/2018,01 nr. 016-28468 të dt. 22. 03.2018 (neni 13 dhe neni 22 paragrafi 1.6)

**Neni 2**
**Vlera e Subvencionimit**

Vlera e subvencionimit sipas nenit 1 paragrafi 1 të kësaj marrëveshje është **400 €** (katërqind euro) dhe pagesa bëhet nga Kodi Buxhetor-Subvencione-Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

**Neni 3**
**Obligimet e palëve**

1. **Obligimet e përfitueses së subvencionit janë:**

   **1.1.**Mjetet e marra përfituesja do t'i shfrytëzoj vetëm për qëllimet siç u cekë më lartë.

   **1.2.**Përfituesja duhet të raportoj tek Komuna e Gjilanit.

**Neni 4**

1. Obligimet e Komunës së Gjilanit janë:

   **1.1.**Obligohet që shumën nga paragrafi 1 i nenit 2 të kësaj marrëveshje t'ia transferoj në xhirollogarinë bankare të përfitueses, sipas kushteve të parapara me këtë marrëveshje;

   **1.2.**Bartja e mjeteve financiare do të bëhet në pajtim me rregullat financiare mbi pagesat.

2. Komuna e Gjilanit mbanë të drejtën e monitorimit/inspektimit dhe auditimit të realizimit të qëllimeve të subvencionimit, po që se paraqitet nevoja.

**Neni 5**
**Afatet kohore**

1. Afatet kohore të kësaj marrëveshje do të jenë obliguese për palët. Palët duhet të informojnë njëra tjetrën në rast të vonesave.
2. Kjo marrëveshje është e vlefshme pas datës së nënshkrimit nga palët.

**Neni 6**
**Kthimi i mjeteve**

Në rast të rrethanave të ndryshme të cilat rezultojnë deri te mos realizimi i subvencioneve, përfituesja është e obliguar t'i kthejë mjetet e pa shpenzuara tek Komuna e Gjilanit.

**Neni 7**
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje eventuale lidhur me këtë marrëveshje, palët do ta zgjidhin vet, me synimin e përmirësimit dhe të realizimit të qëllimit të kësaj marrëveshje.

**Neni 8**
**Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga ana e dy palëve.

**Neni 9**

Marrëveshja është përpiluar në 2 kopje të njëjta ku secila palë do të marrë nga një kopje.

**Komuna e Gjilanit**
**Alban Hyseni, Kryetar**

**Alisa Halimi**